



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 54, Datë 17.02.2026

MBI

SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 304, DATË 17.11.2025 “MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “PROINFINIT CONSULTING” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.02.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 450/1 prot., datë 13.02.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. për shfuqizimin e vendimit të bordit nr. 304, datë 17.11.2025”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 06.06.2023, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 188, datë 06.06.2023.
- Me shkresën nr. 2796 prot., datë 05.11.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion në lidhje me marrjen e autorizimit nga ERE për miratimin e ndryshimit të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 304, datë 17.11.2025, vendosi të japë autorizimin për ndryshimin e ortakëve që kontrollojnë interesat e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. Ortakët e shoqërisë ndryshojnë dhe bëhen Z. A G dhe Z. E K, ku Z. A G bëhet ortaku kryesor që kontrollon interesat e saj (me 65% të kuotave të kapitalit).
- Në vijim, shoqëria me shkresën nr. 450 prot., datë 02.02.2026 ka paraqitur kërkesën për shfuqizimin e vendimit nr. 304/2025, duke sqaruar se kuotat nuk janë transferuar te Z. A G dhe Z. E K, për arsye të prishjes së marrëveshjes së shit-blerjes mes palëve.
- Nga verifikimi i ekstraktit historik të shoqërisë rezulton se nuk është bërë asnjë kalim/ndryshim kuotash, çka përputhet me sa deklaruar nga shoqëria se nuk ka ndodhur asnjë ndryshim në vijim të vendimit 304/2025.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 304, datë 17.11.2025, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI